

VENDIM
Nr. 714, datë 5.12.2018

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 359, DATË 5.6.2003, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHETETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHETIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, 8, pika 3, e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Formulari për inventarizimin e pronës së paluajtshme shtetërore “Objekti një kat “Repart marangozi dhe hidrauliku”, me adresë “Rruga e Dibrës, ish-Shkolla “Skënderbej”, Tiranë”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 359, datë 5.6.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me formularin që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Shërbimi Informativ i Shtetit dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

1. FORMULARI PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(për inventarizimin e pronave të veçanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror **Shërbimi Informativ i Shtetit**
Bashkia Tiranë

Fusha e përdorimit të Pronës **ZYRA DHE AMBIENTE PUNE**

Nr. rend	A			B			C			
	Zona Kadast.& indeksi i hartes	Nr. Pshurise	Lloji i prones	Emri i prones Adresa	Sip. totale e prones (m2)	Nga sip. totale sa ndertes (m2)	Funksioni për të cilin përdoret prona total m²	Institucioni/Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	8130	2 / 47		"Repart marangozi dhe hidrauliku" Adresa: Rruga "Dibres" Ish Shkolla "Skenderbej" TIRANË	324	324	Zyra dhe ambiente pune	Shërbimi Informativ i Shtetit	Shërbimi Informativ i Shtetit	